



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 8.10 2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJET “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10129, DATË 11. 5. 2009 “PËR GJENDJEN CIVILE”, TË NDRYSHUAR”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 2.10.2018, dhe 8.10.2018, mori në shqyrtim dy projektligjet “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11. 5. 2009 “Për gjendjen civile”.

Nisma e parë është propozim i Këshillit të Ministrave dhe nisma e dytë vjen me propozim të një grupi deputetësh.

Meqenëse këto dy nisma kanë për objekt ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10129, datë 11. 5. 2009 “Për gjendjen civile”, Komisioni për Çështjet Ligjore, vendosi t’i shqyrtojë ato njëkohësisht, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina.

Në mbledhjet e Komisionit për të paraqitur dhe mbrojtur projektligjin, si dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, si dhe ekspertët që kanë asistuar në përgatitjen e nismës së deputetëve.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJEVE

Projektligjet e paraqitur për shqyrtim janë propozuar nga Këshilli i Ministrave, si dhe nga një grup deputetësh, sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës, dhe shoqërohen me relacionet përkatëse sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJEVE

1- Projektligji i propozuar nga Këshilli i Ministrave

Sipas relacionit shoqërues, qëllimi i projektligjit synon të përmirësojë disa aspekte të zbatimit të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, që lidhen kryesisht me:

- administrimin e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, në linjë me politikat e administrimit të bazave të të dhënave shtetërore;
- rregullimin e marrëdhënies së punës së nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative si dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, për të qartësuar detyrimet e punëdhënësit, në rastin konkret të kryetarit të bashkisë dhe prefektit të qarkut, të cilët kanë detyrimin për lidhjen e kontratës së punës me nëpunësin e shërbimit të gjendjes civile, që emërohet sipas rregullave të përcaktuara nga DPGJC-ja;
- parashikimin në mënyrë të shprehur qartë për ofrimin e shërbimeve nga zyrat e gjendjes civile për shtetasit me vendbanim në juridiksionin territorial të tyre;
- pezullimin e masës së gjobës për gjashtë muaj, nga hyrja në fuqi e këtij projektligji, për mosdeklarimin e ndryshimit të vendbanimit nga shtetasit brenda afateve ligjore.

2. Projektligji i propozuar nga deputetët

Projektligji vjen si domosdoshmëri e rregullimit kryesisht të situatës së fëmijëve të lindur jashtë vendit, veçanërisht për fëmijët prindërit e të cilëve jetojnë jashtë vendit në mënyrë të parregullt. Shpesh këta prindër nuk mund të sigurojnë akte të rregullta të lindjes ose marrin vetëm një njoftim lindjeje që nuk përfshin informacionin bazë (përfshirë emrin) të kërkuar nga autoritetet shqiptare për të regjistruar lindjen e tyre.

Sipas procedurës aktuale ligjore për të regjistruar një fëmijë të lindur jashtë vendit, prindërit duhet të marrin një certifikatë lindjeje nga vendi i lindjes dhe ajo duhet të jetë në formën e parashikuar nga ligji, të jetë akt i legalizuar, i përkthyer në shqip dhe i notëruar. Ky dokument duhet të verifikohet nga Ministria e Jashtme dhe Ministria e Brendshme e vendit të huaj ose nga bashkë (pasi verifikimi mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin). Pasi përfundimit të këtyre procedurave, fëmija regjistrohet në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri.

Kërkesat burokratike të kësaj procedure shpesh janë të pamundura për t’u përmbushur, veçanërisht për nënat pa dokumente që lindin në vende të huaja dhe që jetojnë në kushte varfërie dhe vulnerabiliteti.

Propozimet e bëra në projektligj i japin përfundimisht zgjidhje edhe rasteve të fëmijëve të lindur në një institucion shëndetësor brenda Republikës së Shqipërisë dhe që nuk deklarohen/regjistrohen në zyrat e gjendjes civile. Sipas projektligjit, ngarkohen me detyrimin për të ndjekur dhe sipas rastit për të kryer regjistrimin e fëmijëve, përveç personave të afërm, edhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë bashkive, si dhe subjektet shtetërore dhe private që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Projektligji i ardhur si nismë deputetësh është konkretizimi i zgjidhjes së shqetësimit të shtruar nga disa organizata të shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare UNHCR dhe UNICEF, si dhe nga ekspertët vendas, për çështjen e mosregjistrimit në Shqipëri të një numri të konsiderueshëm fëmijësh.

Në tryezat e organizuara nga grupi “Miq të fëmijëve” në Kuvend, organizata TLAS (“Klinika ligjore falas, Tiranë”), informoi të pranishmit se vetëm gjatë vitit 2017, ka trajtuar me ndihmë juridike 631 raste të regjistrimit të lindjeve, nga të cilët 380 të lindur në Greqi, ndërkohë që ka identifikuar 300 raste të tjera që nuk mund të zgjidhen as me procedura administrative dhe as përmes gjykatës. Nisur nga kjo situatë TLAS, me mbështetje të UNHCR, ka realizuar studimin “Hartëzimi i personave pa shtetësi në Shqipëri” për periudhën Shtator- Dhjetor 2017. Rezultoi që u identifikuan edhe 1031 persona të tjerë pa shtetësi nga të cilët 96.7 % janë fëmijë, dhe 84% e tyre ndeshin pengesa për marrjen e shtetësisë për shkak të procedurave të regjistrimit të lindjes, dhe janë në pritje për zgjidhjen e çështjes.

Gjithashtu, nga përfaqësues të UNICEF në këto tryeza u vu theksi në plotësimin e detyrimeve që parashikon për vendet anëtare, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe të rekomandimeve të vitit 2012 që Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ka bërë për Shqipërinë.

Gjatë diskutimit të kësaj problematike në grupin “Miq të fëmijëve” në Kuvend, nga deputetët dhe ekspertët u arrit në përfundimin se kjo çështje kërkonte një zgjidhje ligjore.

Grupi i ekspertëve që punon pranë organizatës TLAS paraqiti një grup amendamentesh, të cilat reflektojnë shqetësimet dhe problematikat e ngritura në tryezat e organizuara nga grupi “Miq të fëmijëve”, duke sqaruar se këto ndryshime paraprakisht i janë nënshtruar konsultimit si me aktorët e ekzekutivit, ashtu edhe me organizatat e tjera të shoqërisë civile.

IV. RREGULLIME TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE DHE RIFORMULIME SIPAS NENEVE

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nën për nen të projektligjeve, miratoi këto ndryshime:

▪ PROJEKTLIGJI I PROPOZUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE

Neni 2

Ky nen riformulohet si më poshtë :

“Neni 2

Pika 3 e nenit 27, ndryshohet si më poshtë :

“3.Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, për shtetasit shqiptarë, për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile i shteteve të huaja ose nga përfaqësitë tona diplomatike apo konsullore atje, përcillen në zyrat e gjendjes civile përkatëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës, nga vetë i interesuari ose nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.”

Neni 3

Ky nen riformulohet si më poshtë :

“Neni 3

Pika 2 e nenit 33 ndryshohet si më poshtë:

“Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës i përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 10

Ky nen propozohet të ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

“Në nenin 70, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

" administron arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile të njësive administrative nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë".”

-Në nenin 34 të hiqet fjala “bashki”, ndërsa në nenet 46, pika 1, 61, shkronja “c”, 62, 63, pika 3, 65 shkronjat “d” dhe “g”, hiqen fjalët “njësi administrative ”.

Këto ndryshime bëhen me qëllim përputhjen e ligjit të gjendjes civile me ndryshimet që janë bërë në ligjin e ri për vetëqeverisjen vendore.

Ky ndryshim rezulton me shtimin e disa neneve të reja në tekstin e projektligjit.

2. PROJEKTLIGJI I PROPOZUAR NGA DEPUTETËT

Neni 1

Në këtë nen paragrafi i katërt të riformulohet si më poshtë:

“Gjykata që shqyrton çështjen për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, merr vendim brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur me cilësinë e personit të interesuar zyrën e gjendjes civile.”

-Pas nenit 6 propozohet të shtohen dy nene të reja me këtë përmbajtje:

Neni _

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“Në rastin kur ka përfunduar afati i parashikuar në pikën 3 të këtij neni dhe nuk është bërë deklarimi i vdekjes nga subjektet e përcaktuara në shkronjën a dhe b, i ngarkuari i posaçëm i bashkisë bën deklarimin në zyrën e gjendjes civile ku shtetasi që ka ndërruar jetë, ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin në momentin e vdekjes.

2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“ Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj pike, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile me ministrat që mbulojnë institucionet e përmendura në këtë pikë”.

3. Pika 9 e nenit shfuqizohet.

Neni -

Në nenin 53, pika 1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt edhe në rastet kur me vendim gjyqësor të shkallës së parë vërtetohet fakti juridik i vdekjes. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes kanë të drejtë ta bëjnë subjektet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 52 të këtij ligji.”

Neni 8

Në këtë nen shtohet dhe një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Në shkronjën“a” , pas fjalëve “në nenin 52 “, të hiqet numri “ 3” .

Ky propozim bëhet më qëllim heqjen e gjobës për rastet kur deklarimi i vdekjes nuk bëhet në afatin e parashikuar në pikën 3 të nenit 52 të ligjit.

-Në fund të projektligjit shtohet një nen i ri që parashikon daljen e akteve nënligjore si dhe afatin 3 muor për nxjerrjen e tyre.

Në miratimin në tërësi, duke qenë se projektligjet parashikojnë ndryshime në të njëjtin ligj, Komisioni për Çështjet Ligjore vendosi që të dy projektligjet, së bashku me ndryshimet e miratuara në Komision, të integrohen në një tekst të vetëm, i cili i dërgohet për miratim seancës plenare.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi i shqyrtoi projektligjet në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e anëtarëve të pranishëm miratoi ndryshimet e paraqitura sipas tekstit integral bashkëlidhur, i cili i përcillet për votim seancës plenare.

R E L A T O R E

ELENA XHINA

KRYETAR

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

Tekst Integral

P R O J E K T L I G J

Nr._____/2018

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10129,
DATË 11.5.2009, “PËR GJENDJEN CIVILE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në pikën 7, të nenit 2, pas fjalëve “... janë emrat ...”, shtohen fjalët “... dhe mbiemrat”.

Neni 2

Pika 3 e nenit 27, ndryshohet si më poshtë :

“3.Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, për shtetasit shqiptarë, për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile i shteteve të huaja ose nga

përfaqësitë tona diplomatike apo konsullore atje, përcillen në zyrat e gjendjes civile përkatëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës, nga vetë i interesuari ose nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 3

Pika 2 e nenit 33 ndryshohet si më poshtë :

“Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës i përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 4

Në nenin 34, hiqet fjala “bashki”.

Neni 5

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet “Plotësimet dhe korrigjimet në Regjistrin Kombëtar”;
2. Pas shkronjës “c” shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Për korrigjimin si gabim të provuar material të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, ndiqet procedura e parashikuar në nenin 57/7 e vijues të këtij ligji.”.

Neni 6

Pas nenit 38 shtohet neni 38/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 38/1
Akti i lindjes lëshuar jashtë vendit

- 1.Në rastet kur akti i lindjes i lëshuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik të lindjes me qëllim regjistrimin në zyrat e gjendjes civile.
- 2.Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të lindjes mund ta paraqesin subjektet e parashikuara në nenin 40, të këtij ligji
- 3.Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor në të cilin kanë vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi.

4.Gjykata që shqyrton çështjen për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, merr vendim brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur me cilësinë e personit të interesuar zyrën e gjendjes civile.

5.Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankim, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditësh nga data e depozitimit të tij.”

Neni 7

Në nenin 40, bëhen këto ndryshime:

1.Në pikën 2, pas fjalëve “organet e njësisë së qeverisjes vendore”, shtohen fjalët “njësitë për mbrojtjen e fëmijës”.

2.Shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3.Nëse deklarimi i lindjes së fëmijës, nuk kryhet brenda 60 ditëve nga lindja, nga personat e përcaktuar në pikën 1, deklarimi kryhet nga subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”

Neni 8

Në nenin 41 bëhen këto ndryshime:

1.Shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet edhe në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka ndodhur lindja.”

2.Pika 6 shfuqizohet.

Neni 9

Pas nenit 41 shtohet neni 41/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 41/1, Raportimi dhe regjistrimi i lindjeve me procedurë të veçantë

1. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore, publike dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që për çdo lindje të ndodhur pranë institucioneve të tyre, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile ku prindërit kanë

vendbanimin, dokumentacionin/njoftimet përkatëse. Ky proces kryhet çdo ditë të hënë, për javën pararendëse.

Modalitetet, lloji i dokumentacionit, forma dhe mënyra e komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës që mbulojnë institucionet e lartpërmendura.

2. Për çdo lindje të raportuar sipas pikës 1, të këtij neni, zyra përkatëse e gjendjes civile pasqyron lindjen në regjistrin e përkohshëm.

Ministri përgjegjës për gjendjen civile, përcakton me udhëzim rregulla të hollësishme për krijimin dhe administrimin e regjistrit të përkohshëm të lindjeve të raportuara.

3. Nëse regjistrimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga data e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile informon njësinë për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë vendore, e cila ndërmer veprimet konkrete për vlerësimin e situatës dhe regjistrimin e lindjes në zyrën e gjendjes civile.

Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite, përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”

Neni 10

Në nenin 45, pas pikës 3, shtohet pika 3/a me këtë përmbajtje:

“3/a.Kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë vendit është e paplotësuar rubrika e emrit, plotësimi i saj bëhet në përputhje me procedurën administrative, të përcaktuar me akt nënligjor të Ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”

Neni 11

Në nenin 46 , pika 1, hiqen fjalët “... njësi administrative ...”.

Neni 12

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c)Në rastin kur ka përfunduar afati i parashikuar në pikën 3 të këtij neni dhe nuk është bërë deklarimi i vdekjes nga subjektet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1, i ngarkuari i posaçëm i bashkisë bën deklarimin në zyrën e gjendjes civile ku shtetasi që ka ndërruar jetë, ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin në momentin e vdekjes.

2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj pike, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile me ministrat që mbulojnë institucionet e përmendura në këtë pikë”.

3. Pika 9 e nenit shfuqizohet.

Neni 13

Në pikën 1 të nenit 53, fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt edhe në rastet kur me vendim gjyqësor të shkallës së parë vërtetohet fakti juridik i vdekjes. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes kanë të drejtë ta bëjnë subjektet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 52 të këtij ligji.”

Neni 14

Në nenin 56, pika 1, fjalët “në juridiksionin e së cilës ka ndodhur lindja”, zëvendësohen me fjalët “që ka detyrimin e mbajtjes së aktit të lindjes”.

Neni 15

Në fjalinë e tretë, të pikës 1, të nenit 60, hiqet fjala “... administron ...”.

Neni 16

Në nenin 61 , shkronja “c”, hiqen fjalët “... njësi administrative ...”.

Neni 17

Në nenin 62 , hiqen fjalët “... njësi administrative ...”.

Neni 18

Në nenin 63, pika 3, hiqen fjalët “... njësi administrative ...”.

Neni 19

Pas nenit 64 shtohet neni 64/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 64/1

Marrëdhënia e punës së nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile

Marrëdhënia e punës së nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.”.

Neni 20

Në nenin 65 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjat “d” dhe “g”, hiqen fjalët “... njësi administrative...”;
2. Shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 21

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 68, hiqen fjalët “... njësisë administrative ...”.

Neni 22

Në nenin 69 bëhet shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë:

1. Në shkronjën “a”, në fund të fjalisë shtohen fjalët “... dhe ofrojnë shërbimin e gjendjes civile për shtetas që kanë vendbanimin brenda juridiksionit territorial të tyre;”;
2. Shkronja “dh” ndryshohet, me këtë përmbajtje:
“dh) informojnë kryetarin e bashkisë si dhe zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut për veprimtarinë e tyre, sipas kërkesës së tyre.”.

Neni 23

Në nenin 70, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

"b) administron arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile të njësive administrative nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë".

Neni 24

Në pikën 1 të nenit 74, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, pas fjalëve “në nenin 52”, hiqet numri “3”;
2. Në shkronjën “b”, fjalët “në nenin 41, pika 6”, zëvendësohen me fjalët “në nenin 41/1, pika 1”.

Neni 25

Dispozitë kalimtare

Gjoha e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 74, të ligjit, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 26 Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 9, 10, dhe 12 të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 27 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI